



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

## **Analizë buxhetore**

**Trendet e ndarjeve buxhetore sipas Projektligjit Nr. 07/L-041 mbi ndarjet  
buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021**



Prishtinë, Nëntor 2020

**Përgatitur nga:**  
Drejtoria për Hulumtime, Bibliotekë dhe Arkiv  
Kuvendi i Republikës së Kosovës  
Nr. Tel: 038 200 10 633

## Përmbajtja

<b><i>Përmbledhje Ekzekutive</i></b> .....	<b>3</b>
<b><i>1. Analiza e Tabelës 1</i></b> .....	<b>4</b>
<b><i>2. Trendi i ndarjes së buxhetit sipas organizatave buxhetore</i></b> .....	<b>9</b>
<b><i>3. Buxheti për shëndetësi dhe arsim</i></b> .....	<b>10</b>
<b><i>4. Projektet kapitale</i></b> .....	<b>12</b>
<b><i>5. Aspekti gjinor i projektbuxhetit 2021</i></b> .....	<b>13</b>

## Përmbledhje Ekzekutive

Qëllimi i këtij raporti është që të bëjë një [analizë të ndarjeve buxhetore për vitin 2021](#) dhe t'i krahasoj ato me [buxhetin e rishikuar të vitit 2020](#). Krahasuar me buxhetin e vitit paraprak, është planifikuar që të hyrat të jenë më të larta për 5% dhe kjo si pasojë e rritjes së të hyrave tatimore dhe jo-tatimore. Në anën tjetër, shpenzimet janë planifikuar të bien për 8% dhe kjo reflekton një ulje të deficitit buxhetor nga 6.5% në 4.2%, mirëpo edhe në vitin 2021 deficit do të jetë mbi kufirin e rregullt të deficitit fiskal. Borxhi publik do të vazhdojë të shënoj rritje në 28.3% të Bruto Produktit Vendor (BPV), apo një rritje prej 3.5 pikë përqindje krahasuar me vitin e kaluar.

Sic u theksua më lartë, shpenzimet pritet të kenë një rënie në vitin 2021, mirëpo shpenzimet e rregullta kapitale kanë një rënie gati trefish më të madhe se ato rrjedhëse. Përveç shpenzimeve të rregullta, programi për rimëkëmbje ekonomike planifikohet të ketë në dispozicion buxhet të konsiderueshëm që përbën rreth 8% të shpenzimeve buxhetore apo 3% të BPV-së, së parashikuar. Krahasuar me vitin 2020, shpenzimet për rimëkëmbje ekonomike janë përgjysmuar dhe rreth 60% e ndarjeve do të shkojnë në kategorinë e subvencioneve.

Krahasuar me rishikimin e buxhetit 2020, një pjesë më e madhe e investimeve kapitale do të financohen nga klauzola e investimeve, ndërsa financimi nga fondet e likuidimit për vitin 2021 do të bie dukshëm. Ngjashëm me vitet e kaluara, pjesa më e madhe e projekteve kapitale qendrore janë vazhdime apo obligime nga vitet e kaluara, duke lënë pak hapësirë për projekte të reja. Ministrive të cilave iu është ndarë më shumë buxhet për investime kapitale janë: Ministria e Infrastrukturës (MI), Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), dhe Ministria e Mbrojtjes (MM).


Sikurse në vitin 2020 sipas buxhetit të rishikuar, tri ministritë me kufirin e buxhetit më të lartë në 2021 janë: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Financave. Sa i përket ndarjes sipas kategorizimit funksional, buxheti për shëndetësi dhe buxheti për arsim pritet të reduktohen.

Edhe në [projektbuxhetin 2021](#), sikurse në buxhetet e viteve të kaluara, perspektiva gjinore është e anashkaluar.

## 1. Analiza e Tabelës 1

Të hyrat buxhetore pritet të jenë 1.88 miliardë euro, gjë që është 97.4 milionë euro apo rreth 5% më shumë se sa të hyrat e buxhetit të rishikuar të vitit 2020. Në anën tjetër, shpenzimet buxhetore pritet të ulen nga 2.62 miliardë euro në buxhetin e rishikuar të 2020 në 2.41 miliardë euro në projektbuxhetin për vitin 2021, gjë që shënon ulje prej afro 8%. Sa i përket nevojës për financim, është ulur buxheti nga 832 milionë euro (2020) në 527 milionë euro (2021). Më gjithë rënien e nivelit të financimit, deficitin buxhetor do të jetë 4.2% e BPV-së, apo rreth 2.2 pikë përqindje më i lartë se kufiri i deficitit të rregullt buxhetor.<sup>1</sup> Në parashikimet e MF-së, deficitin buxhetor do të jetë më i lartë së 2% e BPV-së edhe në 2022.

Figura 1. Struktura e projektbuxhetit 2021 (në miliona)



Borxhi i përgjithshëm si përqindje e BPV-së, pritet të jetë 28.3% gjatë vitit 2021. Në fakt, sipas të dhënave nga Banka Botërore për Ballkanin Perëndimor, edhe pse borxhi publik i Kosovës është vazhdimisht duke u rritur, ai është megjithatë më i ulët se sa në shtetet e rajonit. Gjatë vitit 2020, Shqipëria kishte një borxh publik prej 76.2% të BPV-së, Serbia 55.3%, Mali i Zi 92.9% dhe Maqedonia e Veriut 50.8%.<sup>2</sup>


Në projektbuxhetin e 2021, pjesën dërrmuese të hyrave të rregullta buxhetore do ta përbëjnë të hyrat tatimore të cilat janë 96 milionë euro apo rreth 6% më shumë se sa në vitin paraprak. Gjithashtu, rritje prej 25 milionë euro shënojnë edhe të hyrat jo-tatimore në projektbuxhetin e

<sup>1</sup> Ligji nr. 04/l-194 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/l-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësu- ar me ligjet nr. 03/l- 221 dhe nr. 04/l-116, neni 22A

<sup>2</sup> “Western Balkans Regular Economic Report: Fall 2020,” faqe 83, Banka Botërore, Vjeshtë 2020. Burimi: <https://bit.ly/38oFcNt>


vitit 2021. Në të hyrat tatimore, kontribut të theksuar në rritje pritet që ta kenë të hyrat nga kufiri, ndërsa tek të hyrat jo-tatimore pritet një rritje më e theksuar nga taksat koncesionare. Grantet për mbështetje buxhetore bien për 23 milionë euro ndërsa grantet e përcaktuara të donatorëve kanë mbetur në nivelin e njëjtë, krahas rishikimit 2020.

Figura 2. Të hyrat e rregullta buxhetore (në miliona)




Nëse e shikojmë strukturën e shpenzimeve të projektbuxhetit 2021, shpenzimet e rregullta rrjedhëse shënojnë ulje prej 103 milionë euro apo 6% më pak se sa në buxhetin e rishikuar të vitit 2020. Shpenzimet kapitale ndjekin trendin rënës edhe më të shpejtë me një ulje prej 114 milionë euro apo 16% nga buxheti i vitit 2020. Si pasojë e pandemisë me COVID-19, në buxhetin e rishikuar të vitit 2020 për planin për rimëkëmbje ekonomike ishin ndarë 365 milionë euro. Megjithatë, gjatë vitit 2021 buxheti për planin për rimëkëmbje është përgjysmuar në 182 milionë euro.

Figura 3. Shpenzimet rrjedhëse dhe kapitale (në miliona)




Sa i përket shpenzimeve kapitale në bazë të komponentëve të tyre (buxheti i rregullt, klauzola e investimeve dhe fondet e likuidimit të AKP), në projektbuxhetin e vitit 2021 shihet se 64% e shpenzimeve kapitale pritet të financohen nga buxheti i rregullt, gjë që shënon një rritje prej 10 pikë përqindje krahasuar me buxhetin e vitit 2020. Gjithashtu, rritje shënon edhe klauzola e investimeve me 12 pikë përqindje më shumë se sa në vitin paraprak. Në anën tjetër, fondet e likuidimit të AKP-së, bien për 47 milionë euro në krahasim me buxhetin e vitit 2020, gjë që shënon një ulje të peshës së tyre në financimin e shpenzimeve kapitale nga 25% në vitin 2020 në vetëm 4% në projektbuxhetin e 2021.

Figura 4. Financimi i shpenzimeve kapitale (në miliona)



Gjatë vitit 2021 pritet që shpenzimet rrjedhëse si pagat dhe shtesat të rriten për 4 milionë euro (1%), nga 621 milionë euro në vitin 2020 në 625 milionë euro gjatë vitit 2021. Shpenzimet për mallra dhe shërbime gjithashtu pritet të ulen nga 315 milionë euro (2020) në 311 milionë euro (2021). Subvencionet dhe transferet pritet të shohin uljen më të madhe prej 36 milionë euro – nga 679 milionë euro (2020) në 643 milionë euro (2021). Në anën tjetër, rezervat rrjedhëse pritet të shohin rritje nga 34 milionë euro në buxhetin e vitit 2020 në 41 milionë euro në projektbuxhetin për vitin 2021.


Figura 5. Shpenzimet rrjedhëse (në miliona)



**Buxheti për rimëkëmbje ekonomike**, do të jetë 182.4 milionë euro, apo 168 milionë euro më pak se në vitin 2020. Paga dhe shtesa do të jenë 14 milionë euro, gjë që ishte njëjtë sikurse në buxhetin e rishikuar të vitit 2020. Mallrat dhe shërbimet pritet të kenë mbështetje prej 10 milionë euro si pjesë e projektbuxhetit për vitin 2021 në krahasim me 13 milionë euro me buxhetin e rishikuar 2020. Subvencionet dhe transferet gjithashtu pritet të kenë më pak buxhet (106 milionë euro) gjatë vitit 2021 në krahasim me vitin 2020 (111 milionë euro). Shpenzimet kapitale përmes klauzolës për investime dhe nën-huazime pritet të kenë më pak mbështetje nga pako gjatë vitit 2021 (44 milionë euro) se sa në vitin 2020 (53 milionë euro).



Figura 6. Shpërndarja e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike (në miliona)



## 2. Trendi i ndarjes së buxhetit sipas organizatave buxhetore

Institucionet që pritet të kenë uljen më të madhe në buxhet sipas projektbuxhetit të vitit 2021 janë: Ministria e Financave me 162 milionë euro, më pak se në buxhetin e rishikuar të vitit 2020, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit me 55.5 milionë euro, më pak se në vitin 2020, Ministria e Shëndetësisë me 25.5 milionë euro më pak, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, me 12.8 milionë euro më pak, Ministria e Punëve të Brendshme me 6.4 milionë euro më pak, dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me 3.6 milionë euro më pak. Për dallim, Ministria e Infrastrukturës pritet të ketë rritjen më të madhe sipas projektbuxhetit për 2021 (53.9 milionë euro më shumë) krahasuar me buxhetin e rishikuar gjatë vitit 2020, që ndiqet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me 29.8 milionë euro më shumë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me 4.4 milionë euro më shumë, dhe Ministria e Mbrojtjes me 3.7 milionë euro më shumë.

Tabela 1. Ministritë dhe institucionet me dallimin më të madh në kufijtë e buxhetit sipas projektbuxhetit 2021 në krahasim me buxhetin e rishikuar 2020


Ministritë/Institucionet	Totali 2020	Totali 2021	Ndryshimi (2021-2020)	
Ministria e Infrastrukturës	€ 167,834,711.00	€ 221,695,294.00	€ 53,860,583	
Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale	€ 481,075,413.00	€ 510,852,293.00	€ 29,776,880	
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	€ 6,556,482.00	€ 10,923,404.00	€ 4,366,922	
Ministria e Mbrojtjes	€ 63,602,303.00	€ 67,317,674.00	€ 3,715,371	
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	€ 38,546,391.00	€ 34,905,709.00	-€ 3,640,682	
Ministria e Punëve të Brendshme	€ 148,722,254.00	€ 142,286,899.00	-€ 6,435,355	
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	€ 117,086,367.00	€ 104,236,139.00	-€ 12,850,228	
Ministria e Shëndetësisë	€ 82,676,504.00	€ 57,182,643.00	-€ 25,493,861	
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit	€ 138,375,401.00	€ 82,902,178.00	-€ 55,473,223	
Ministria e Financave	€ 383,508,527.00	€ 221,154,434.00	-€ 162,354,093	

Sipas projektbuxhetit të vitit 2021 pritet që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale sërish të menaxhoi më së shumti buxhet me vlerë prej 510.9 milionë euro, gjë që është më shumë se në buxhetin e rishikuar të vitit 2020 (481 milionë euro). Sa i përket shpenzimeve kapitale, Ministria e Infrastrukturës rangohet e para me shpenzime në vlerë prej 204.7 milionë euro, gjë që është më shumë se në vitin 2020 (afro 150 milionë euro). Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale gjithashtu zotëron vendin e parë me vlerën më të madhe të pritshme të subvencioneve dhe transfereve prej 489.2 milionë euro, gjë që është më shumë se sa në buxhetin e rishikuar të vitit 2020 (471.6 milionë euro). Në aspektin e shpenzimeve komunale, vendin e parë e zë Ministria e Punëve të Brendshme, e cila pritet të ketë 4.9 milionë euro në dispozicion për atë kategori, në krahasim me 4.2 milionë sipas buxhetit të rishikuar të vitit 2020. Nga kategoria e pagave dhe mëditjeve, Ministria e Punëve të Brendshme, renditet e para për buxhetin e pritshëm të vitit 2021 me një vlerë prej 76.7 milionë euro apo më pak se sa në buxhetin e rishikuar të vitit 2020 (87 milionë euro).

### 3. Buxheti për shëndetësi dhe arsim

Projektbuxheti 2021 parasheh një buxhet për shëndetësi (që përfshinë Ministrinë e Shëndetësisë, Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, dhe Grantin për Shëndetësi për komuna), prej 231.5 milionë euro, gjë që është 39.3 milionë euro apo 15% më pak se sa në buxhetin e rishikuar të vitit 2020. Reduktimi më i madh vjen si pasojë e shkurtimit të buxhetit për Ministrinë e Shëndetësisë, e cila pritet të ketë 25.5 milionë euro më pak krahasuar me buxhetin e rishikuar 2020.

Figura 7. Buxheti për shëndetësi




Shuma e ndarë sipas projektbuxhetit për vitin 2021 për shëndetësi si përqindje e BPV-së është 3.2%. Prej të dhënave më të fundit të vitit 2017, vendet e rajonit shpenzojnë një përqindje më të madhe në shëndetësi si për shembull Shqipëria 4%, Serbia 5%, Maqedonia e Veriut 4%, dhe Bosnja dhe Hercegovina 6%.<sup>3</sup>

Sa i përket buxhetit për arsim (që përfshinë Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, dhe Grantin për Arsim), projektbuxheti 2021 parasheh 261.3 milionë euro, të cilat janë 8.4 milionë euro apo 3% më pak se sa në buxhetin e rishikuar të vitit 2020. Pjesa dërrmuese e buxhetit parashihet për grantin për arsim në komuna (196 milionë euro), pastaj për MASHT (64.1 milionë), dhe së fundi për Akademinë e Shkencave dhe Arteve me 1.2 milionë euro.

<sup>3</sup> “Domestic General Government Health Expenditure (GGHE-D) si përqindje e BPV-së,” Global Health Expenditure Database, OBSH

Figura 8. Buxheti për arsim



Edhe në arsim, shumta e buxhetit të ndarë është vetëm 3.7% e BPV-së. Në krahasim, gjatë vitit 2017, vendet e BE shpenzonin disa herë më shumë se sa Kosova: Islanda 7.3%, Suedia 6.7%, Danimarka 6.5%, ndërsa mesatarja e 27 shteteve të BE-së, për shpenzime në arsim si pjesë e BPV-së, ishte 4.6%.<sup>4</sup>

## 4. Projektet kapitale

Buxheti total për projekte kapitale të nivelit qendror është 478.5 milionë euro, ku 459.8 milionë euro janë për projekte në vazhdim nga 2020, ndërsa 18.7 milionë euro janë për projekte të reja. Totali i buxhetit për projekte kapitale i udhëhequr vetëm nga ministrinë pritet të jetë 452.3 milionë euro, ku pjesën dërrmuese e përbëjnë projektet në vazhdim nga viti 2020 me vlerë prej 434 milionë euro. Disa ministri të cilat pritet të menaxhojnë krahasimisht më shumë fonde janë: *Ministria e Infrastrukturës (MI)*, *Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA)*, dhe *Ministria e Mbrojtjes (MM)*. MI pritet të menaxhojë 204.7 milionë euro, prej të cilave 194.3 milionë euro janë për projekte në vazhdim nga viti 2020 ndërsa 10.4 milionë euro janë për projekte të reja. MEA pritet të ketë 60.4 milionë euro nën udhëheqje, prej të cilave 54.7 milionë euro janë për projekte në vazhdim nga 2020 ndërsa 5.7 milionë euro janë për projekte të reja, ku 1.5 milionë euro do t'u takoj projekteve për trajtimin e ujërave të zeza në Mitrovicë dhe Prishtinë. Ministria e Mbrojtjes ka 29.9 milionë euro ndarje buxhetore për

<sup>4</sup> "General government expenditure by function (COFOG)," Eurostat. Burimi: <https://bit.ly/38qCpnb>

Përgatitur nga:


Drejtoria për Hulumtime, Bibliotekë dhe Arkiv

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Nr. Tel: 038 200 10 633

projekte kapitale, mirëpo buxheti për projekte të reja do të ketë vlerë prej 1 milionë euro, të cilat shkojnë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Figura 9. Buxheti për projekte kapitale\*



\* Pesë ministritë me më së shumti buxhet për projekte të reja gjatë vitit 2021

## 5. Aspekti gjinor i projektbuxhetit 2021

Buxheti i Kosovës është një nga instrumentet më të rëndësishme shtetërore më anë të cilit adresohen problemet ekonomike, sociale, arsimore dhe kulturore. Kontribuues në buxhetin e Kosovës, janë të gjithë qytetarët e Kosovës, pa marrë parasysh gjininë, moshën apo etninë. Si i tillë, buxheti duhet t’i adresoj problemet e të gjitha shtresave shoqërore në Kosovë. Në vijim janë paraqitur disa të gjetura lidhur me adresimin e çështjeve gjinore në Projektbuxhetin e vitit 2021.

Megjithëse, [Ligji Nr. 05/L-020 për barazi gjinore](#) kërkon që perspektiva gjinore të futet në çdo fazë të procesit të planifikimit, miratimit, zbatimit dhe vlerësimit të legjislacionit, në dokumentet e procesit të hartimit të buxhetit nuk është bërë asnjë vlerësim i ndikimit gjinor. [Korniza Afatmesme e Shpenzimeve e Rishikuar 2021-2023](#), nuk paraqet një vlerësim të ndikimit gjinor. Madje, termi “gjinor” përmendet vetëm tri herë në një dokument 90 faqesh.<sup>5</sup>

Në qarkoret buxhetore për projektbuxhetin e vitit 2021, Ministria e Financave ka kërkuar që të respektohet Ligji për barazi gjinore, duke kërkuar nga organizatat buxhetore përfshirjen e

<sup>5</sup> “Korniza Afatmesme e Shpenzimeve e Rishikuar 2021-2023” Ministria e Financave, Shtator 2020. Burimi: <https://bit.ly/3k7xF7V>

buxhetimit gjinor si mënyrë për të bërë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në barazinë gjinore.<sup>6</sup> Mirëpo, fatkeqësisht në asnjërin nga dokumentet e hartimit të projektbuxhetit nuk shohim një vlerësim të tillë. Në nivel lokal vetëm 16 nga 38 Komuna apo më pak së gjysma e komunave kanë paraqitur buxhetin e ndarë për çështje gjinore. Krahasuar me vitin e kaluar buxheti për çështje gjinore në komuna ka rënë për 6.4%.

Në Kosovë vetëm 14% e grave janë të punësuar, krahasuar me 44% të burrave.<sup>7</sup> Të dhënat tregojnë se gratë nuk kanë mungesë të aftësive, sepse më shumë gra punëkërkuese kanë të përfunduar studimet bazë krahasuar me burrat.<sup>8</sup> Mirëpo, struktura aktuale e ekonomisë së Kosovës duket se nuk e përkrah punësimin e gruas. Një ndër arsytet për këtë është edhe buxheti i Kosovës, i cili vazhdon të investohet në sektorë të cilët nuk gjenerojnë vende pune për gra. Përderisa 98% e të punësuarve në ndërtimtari janë burra dhe vetëm 2% gra, më shumë se një e treta e investimeve kapitale (39%) të projektbuxhetit 2021, janë planifikuar të shpenzohen në infrastrukturë rrugore. Gjithashtu, edhe për Ministrinë e Bujqësisë pritet të këtë 49.5 milionë euro subvencione dhe transfere, në industrinë e bujqësisë 87% janë burra të punësuar në krahasim me 13% gra.<sup>9</sup>

Përveç mënyrës indirekte të krijimit të pabarazisë gjinore përmes investimeve kapitale, gratë dhe burrat përfitojnë në mënyrë joproporcionale nga pagat në buxhetin e Kosovës. 67% e shërbyesve civil në ministri janë burra, krahasuar me 33% gra, gjë që vërehet edhe në nivel lokal ku poashtu 67% të - të punësuarve janë burra kurse 37% gra. Pabarazia është edhe më e lartë nëse shikojmë ndarjen gjinore në pozita drejtuese, me vetëm 28% të grave krahasuar me 72% burra. Nëse shikojmë statistikën për përfaqësimin e grave në nivele të larta drejtuese në shërbimin civil në nivel qendror, situata është edhe më alarmante. Nga 88 pozita të tilla, vetëm 10 prej tyre janë gra.

Një mënyrë tjetër direkte e diskriminimit të grave përmes buxhetit është ndarja e benefiteve sociale. Përfituesit më të mëdhenj të benefiteve sociale të cilat jepen për familjet me të paktën një fëmijë nën moshën pesë vjeçare, janë pikërisht burrat 92% krahasuar me 8% gra.<sup>10</sup>

---

<sup>6</sup> Qarkoret Buxhetore 2021, Ministria e Financave, 2020. Burimi: <https://bit.ly/2IcPAgE>

<sup>7</sup> “Anketa e Fuqisë Punëtore TM1 2020,” Agjencia e Statistikave të Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/35bo6AV>

<sup>8</sup> “Punësimi dhe përfaqësimi i grave në Kosovë,” Institutit GAP, 2019. Burimi: <https://bit.ly/2IeMnmE>

<sup>9</sup> “Anketa e Fuqisë Punëtore TM1 2020,” Agjencia e Statistikave të Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/35bo6AV>

<sup>10</sup> “Menaxhimi i Buxhetit Familjar: grate dhe burrat,” Instituti GAP, Tetor 2017. Burimi: <https://bit.ly/3n1DYff>

Publikimi i këtij dokumenti është mbështetur nga populli zemërgjerë Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimet e USAID dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

